



BALFIN SHPK

Pasqyrat Financiare te vecanta per vitin ushtrimor 2017

PËRMBAJTJA

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR.....	2
PASQYRA PËRMBLEDHËSE E TË ARDHURAVE	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL.....	4
PASQYRA E FLUKSEVE TË PARASË	5
SHENIMET E PASQYRAVE FINANCIARE	6-21

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Aksionerin e Balfin sh.p.k

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Balfin sh.p.k (Shoqëria), që përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2017, si dhe pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të Shoqërisë paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2017, si dhe të rezultatit të saj financiar dhe të fluksit të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK).

Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin Përgjegjësia e Audituesit për auditimin e pasqyrave financiare të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në pajtim me Bordin e Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kodin e Kontabilistëve të Etikës për Kontabilistët Profesionistë (Kodit IESBA) së bashku me kërkesat etike që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe te Kodit IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Çështje të tjera

Tërheqim vëmendjen në Shënimin 2 të pasqyrave financiare, që tregon Bazat e përgatitjes të pasqyrave financiare dhe faktin që këto pasqyra financiare janë përgatitur për qëllim të përmbushjes së kërkesave ligjore për auditimin e pasqyrave financiare vjetore. Si rredhojë këto pasqyra financiare nuk mund të jenë të përshtatshme për një qëllim tjetër.

Përgjegjësitë e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SKK-të, dhe për ato kontrole të brendshme, që Drejtimi i i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Drejtimi është përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomali mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticismin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomaliave materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencat auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të bazuar opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa një që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosdhënie e vetëdijshme e gjithë informacionit, keq-përfaqësime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptim të kontrollit të brendshëm të lidhur me auditimin me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të cilat janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël dhe informacioneve të lidhura shpjeguese të bëra nga drejtimi.
- Duke u bazuar në evidencat e auditimit, nxjerrim përfundime mbi përshtatshmërinë e përdorimit nga ana e drejtimit të parimit të vijimësisë si bazë kontabël, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse në aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit tek informacionet shpjeguese të pasqyrave financiare ose nëse këto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të ndryshojmë opinionin tonë. Përfundimet tona të auditimit bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të shkaktojnë që Shoqëria të ndalojë së vazhduari në vijimësi.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin veprimet dhe ngjarjet e ndodhura në mënyrë që të arrijnë një prezantim të drejtë.

Ne komunikojmë me Drejtimin e Balfin sh.p.k, midis të tjerash, lidhur me qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, duke përfshirë çdo mangësi të rëndësishme të kontrollit të brendshëm që kemi identifikuar gjatë auditimit tonë.

Ernst & Young - Ekspertë Kontabël të Autorizuar
Dega në Shqipëri

Ernst & Young Certified Auditors

29 mars 2018
Tiranë, Shqipëri

Mario Vangjel
Ekspert Kontabël i Regjistruar




BALFIN SH.P.K*(Gjithe vlerat jane shprehur ne mije Lek)***PASQYRA E POZICIONIT FINANCIARE**


AKTIVET	Shenime	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Aktivet Afatshkurtra			
Mjete monetare	4	2,366,136	3,100,743
Totali		2,366,136	3,100,743
Aktive të tjera financiare afatshkurtra			
Kërkesa te arkëtueshme	5	124,034	68,538
Huadhenie afatshkurtër brenda grupit	6	1,147,239	667,097
Investime te tjera	7	141,913	-
Kërkesa të tjera të arkëtueshme	8	215,249	325,118
Totali		1,628,435	1,060,752
Parapagesa për furnizime dhe shpenzimet e shtyra	9	13,070	2,841
Totali		13,070	2,841
TOTALI I AKTIVEVE AFATSHKURTRA		4,007,641	4,164,336
Aktivet Afatgjata			
Investimet financiare afatgjata			
Aksione dhe pjesmarrje të tjera në njësi te kontrolluara	10	5,887,819	3,894,581
Aksione dhe investime të tjera në pjesëmarrje	11	134,502	271,466
Kërkesa te arkëtueshme afatgjata	12	873,758	819,226
Tituj të huadhënies në njësitë brenda grupit	13	-	421,453
Tituj te tjere te huadhenies	13	147,544	559,146
Totali		7,043,623	5,965,872
Aktive afatgjata material	14		
Makineri dhe paisje		5,315	4,946
Aktive të tjera afatgjata materiale		42,146	25,124
Totali		47,462	30,070
Aktivet afatgjata jomateriale			
Aktive të tjera afatgjata jomateriale	14	580	725
Totali		580	725
TOTALI AKTIVEVE AFATGJATA		7,091,665	5,996,667
TOTALI AKTIVEVE		11,099,306	10,161,003
PASIVET DHE KAPITALI			
Hua dhe detyrime afatshkurtra	15	74,486	226,789
Totali		74,486	226,789
Hua dhe parapagime			
Te pagueshme ndaj furnitorëve	16	33,136	52,393
Detyrimet tatimore	17	8,634	6,059
Totali		41,770	58,452
TOTALI I PASIVEVE AFATSHKURTRA		116,256	285,242
Hua të tjera afatgjata	18	2,362,164	2,751,881
TOTALI I PASIVEVE AFATGJATA		2,362,164	2,751,881
TOTALI I PASIVEVE		2,478,420	3,037,123
Kapitali aksionar		3,216,205	3,216,205
Rezerva ligjore		200	200
Fitimet e pashpëmdara		3,907,475	1,069,408
Fitimi e vitit financiar		1,497,006	2,838,067
TOTALI I KAPITALIT		8,620,886	7,123,880
TOTALI I PASIVEVE DHE KAPITALIT		11,099,306	10,161,003

Bilanci kontabël duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

PASQYRA E TE ARDHURAVE GJITHEPERFSHIRESE

	Shenime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016
Te ardhura nga dividendët	19	1,651,704	3,242,124
Të ardhura te tjera	20	265,787	261,455
Totali i te ardhurave		1,917,491	3,502,580
Shpenzime nga veprimtari e shfrytëzimit	21	(257,963)	(489,440)
Shpenzime të personelit	22	(152,597)	(106,336)
Pagat		(139,595)	(96,880)
Shpenzimet e sigurimeve shoqërore		(13,002)	(9,456)
Zhvlerësimi dhe amortizimi		(9,874)	(7,424)
Fitimi nga veprimtari e shfrytëzimit		1,497,057	2,899,379
Të ardhura / (shpenzime) nga interesi, neto	23	55,653	(2,704)
Humbje nga kursi i këmbimit, neto	24	(55,703)	(58,608)
Të ardhurat dhe shpenzimet financiare, neto		(50)	(61,312)
Fitimi para tatimit		1,497,006	2,838,067
Shpenzimet e tatimit mbi fitimin (15%)	25	-	-
Fitimi neto e vitit financiar		1,497,006	2,838,067

Emri/Firma

Administratori

Emri/Firma

Menaxheri e Financës



Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

BALFIN SH.P.K*(Gjithë vlerat janë shprehur në mijë Lek)***PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITAL**

	Kapitali aksionar	Rezerva ligjore	Fitim i pashpërndarë	Totali
Pozicioni më 31 dhjetor 2015	3,216,205	200	1,069,407	4,285,812
Fitimi neto për periudhën kontabël	-	-	2,838,067	2,838,067
Pozicioni më 31 dhjetor 2016	3,216,205	200	3,907,474	7,123,879
Fitimi neto për periudhën kontabël	-	-	1,497,006	1,497,006
Pozicioni më 31 dhjetor 2017	3,216,205	200	5,404,481	8,620,886

Pasqyra e ndryshimeve ne kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

BALFIN SH.P.K*(Gjithë vlerat janë shprehur në mijë Lek)***PASQYRA E FLUKSIT TE MJETEVE MONETARE**

Shenime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016
Fluksi parave nga veprimtaritë e shfrytëzimit		
Fitimi para tatimit	1,497,006	2,838,295
Rregullimet për:		
Te ardhurat nga dividendet	9/14 (1,651,704)	(3,241,124)
Amortizimin	17 9,874	7,424
Humbjet nga këmbimet valutore	55,703	27,503
Fitime nga shitja e aktiveve afatgjate	13 (47)	(466)
(Rritje) / rënie kerkesat e arketueshme	(10,390)	108,926
(Rënie) / rritje në tepricën detyrimeve, për t'u paguar nga aktiviteti	(16,683)	87,493
Paraja neto nga aktivitetet e shfrytëzimit	(116,240)	(171,949)
Fluksi i parave nga veprimtaritë e investuese		
Blerja e shoqërisë së kontrolluar	(1,979,544)	(1,099,766)
Rritje në investime të tjera	123,271	521,262
Blerja e aktiveve afatgjata materiale	13 (27,115)	(14,081)
Të ardhura nga shitja e paisjeve	176	2,345
Dividendët e arkëtuar	1,651,704	3,241,124
Hua të dhena	12 210,999	(14,865)
Paraja neto, e përdorur në aktivitetet e investuese	(20,509)	2,636,020
Fluksi i parave nga veprimtaritë e financiare		
Huamarrje	(542,020)	497,000
Interesi i paguar	3,677	(10,642)
Interesi i arketuar	(59,330)	13,346
Para neto e përdorur në aktivitetet financiare	(597,673)	499,704
Rritja/renia neto e mjeteve monetare nga aktiviteti	(734,607)	2,963,775
Mjete monetare në fillim të periudhës kontabel	6 3,100,742	136,967
Mjete monetare në fund të periudhës kontabel	2,366,136	3,100,742

Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. INFORMACIONE TE PERGJITHESHME

Balfin sh.p.k. është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me datë 25 Tetor 2007 dhe është regjistruar në Qendren Kombëtare të Regjistrimit në regjistrin e shoqërive tregtare në të njëjtën ditë, me kapital të nënshkruar prej 100,000 leke. Me datë 08.04.2008 në Qendren Kombëtare të Regjistrimit, shoqëria ndryshon emrin e saj nga Samir Mane Consulting Group në Balfin Shpk. Me datë 24.10.2008 në Qendren Kombëtare të Regjistrimit rritet kapitali i shoqërisë me 12,300,000 leke, në datën 05.07.2009 në Qendren Kombëtare të regjistrimit rritet kapitali i shoqërisë me 2,330,580,000 leke. Në datën 19.03.2012 në Qendren Kombëtare të Regjistrimit rritet kapitali i shoqërisë në natyrë për vlerën 873,225,000 leke Kapitali i shoqërisë në 31.12.2014 është 3,216,205,000 leke. Administrator është Znj. Edlira Muka dhe aksioner i vetëm është Z. Samir Mane i cili zoteron 100% të aksioneve të shoqërisë me vlerë nominale për një aksion 32,162,050 leke.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave perkatëse të Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, nga statuti i saj dhe legjislacioni shqiptar në fuqi për tatimet dhe taksat.

Objekti: Aktiviteti i shoqërisë është investimi dhe konsulenca.

Certifikimi tatimor: NIPT K72223031K

Forma juridike e shoqërisë: Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar

Adresa e selisë: ABA Business Center, Kati 11, Tiranë

Shoqëria kryen aktivitetin e saj në ambiente që janë të mara me qira.

2. BAZA E PREGATITJES SE PASQYRAVE FINANCIARE

2.1 Deklarate e pajtueshmërisë

Kompania ka përgatitur këto pasqyrat financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (“SKK”) për pasqyrat financiare të vecanta me qëllim plotësimin e kërkesave për raportim të pasqyrave financiare ligjore.

Meqenëse SKK kërkon përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara, pasqyrat financiare të vecanta mund të mos jenë të mjaftueshme për t’u përdorur si pasqyra financiare me qëllim të përgjithshëm për të plotësuar kërkesat e gjithë përdoruesve të pasqyrave financiare. Pasqyrat e konsoliduara të Shoqërisë do të lëshohen pas datës së aprovimit të këtyre pasqyrave.

Shoqëria i mban të dhenat e kontabilitetit dhe publikon pasqyrat e saj financiare të vitit 2017 në bazë të Standardeve Kombëtare të Raportimit Financiar (“SKK”), të shpallura me Urdhërin e Ministrisë të Financave Nr. 4292 datë 15.06.2006 dhe në përputhje me Ligjin mbi kontabilitetin no: 9228 datë 29 Prill 2004 “Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar.

Aktivitetet financiare dhe detyrimet financiare janë të kompensuar dhe shumat neto raportohen në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur ka të drejtë ligjore për t’i kompensuar shumat e njohura dhe ka një përpyetje për t’i vendosur në bazë neto, ose për realizimin e aktiveve dhe shlyerjen e detyrimeve njëkohësisht. Të ardhurat dhe shpenzimet nuk janë të kompensuar në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse pasi nuk kërkohet ose lejohet nga ndonjë standard i kontabilitetit ose interpretim, dhe ndonjë politikë kontabël e Shoqërisë.

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3 Monedha funksionale dhe e prezantimit

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2. BAZA E PREGATITJES SE PASQYRAVE FINANCIARE (VAZHDIM)**2.4 Vlerësime dhe gjykime**

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që Drejtuesit të ushtrojnë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të Shoqërisë dhe në njohjen dhe matjen e shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

Në veçanti, informacioni mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishëm në shumën e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet shpjeguese përkatëse të këtyre pasqyrave financiare.

3 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL**3.1 Transaksionet në monedhë të huaj**

Transaksionet në monedhë të huaj këmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit këmbehen në monedhë funksionale me kursin e këmbimit të asaj date. Fitimi ose humbja nga kurset e këmbimit për zërat monetarë është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhë funksionale në fillim të vitit dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj të këmbyerës me kursin e këmbimit në fund të vitit.

Aktivitetet dhe detyrimet jo-monetare të nominuara në monedhë të huaj të cilat maten me vlerë të drejtë këmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës në të cilën është përcaktuar vlera e drejtë. Zërat jo-monetarë në monedhë të huaj të cilat maten me kosto historike këmbehen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Kurset e këmbimit zyrtare bankare të zbatuara sipas Bankës së Shqipërisë (Lek kundrejt njësisë së monedhës së huaj) për monedhat kryesore më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 ishin si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
USD	111.1	128.17
EUR	132.95	135.23

3.2 Instrumentat Financiare

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme, mjete monetare dhe të tjerë ekuivalentë, huamarrje, dhe llogari të pagueshme dhe të tjera të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitetet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur Shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën Shoqëria

BALFIN SH.P.K

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Gjithë vlerat janë shprehur në mijë Lek)

angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të Shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

3 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

3.2 Instrumentat Financiare (vazhdim)

Investimet në shoqeri të kontrolluara

Shoqeria përgatit pasqyra financiare të veçanta dhe për kontabilizimin e investimeve të saj në njësitë e kontrolluara përdorë si politikë kontabël koston e investimit minus zhvlerësimin.

Investimet në pjesëmarrje

Pjesëmarrjet janë të gjitha ato njësi mbi të cilat Shoqeria ka një ndikim të rëndësishëm në politikat e saj financiare dhe të shfrytëzimit, por nuk i kontrollon ato. Ndikimi i rëndësishëm presupozohet se ekziston kur Shoqeria zotëron në mënyrë direkte ose të tërthortë, nëpërmjet shoqërive të kontrolluara, më shumë se 20% të së drejtës votuese të pjesëmarrjes, përveç rasteve përjashtimore kur mund të tregohet qartë se një zotërim i tillë nuk përbën ndikim të ndjeshëm. Ndikimi i ndjeshëm mund të ekzistojë, edhe nëse zotërohen më pak se 20%, kur një ndikim i tillë mund të demonstron qartë.

Modeli i kostos

Shoqeria i mat investimet e saj në pjesëmarrje me kosto pakësuar me ndonjë humbje nga zhvlerësimi i akumuluar i njohur në përputhje me SKK 5.

Shoqeria njihë dividendët dhe shpërndarje të tjera të marra nga investimi si të ardhura pa marrë parasysh nëse shpërndarjet janë nga fitimet e akumuluar të pjesëmarrjes para ose pas datës së blerjes.

Investimet në sipërmarrjet e përbashkëta

Kontrolli i përbashkët është ndarja, sipas një marrëveshjeje kontraktuale, e kontrollit mbi një aktivitet ekonomik, dhe ekziston vetëm kur vendimet strategjike financiare dhe të shfrytëzimit që lidhen me aktivitetin kërkojnë pëlqimin unanim të palëve që ndajnë kontrollin (sipërmarrësit).

Një sipërmarrje e përbashkët është një marrëveshje kontraktuale sipas të cilës dy apo më shumë palë ndërmarrin një veprimtari ekonomike që është subjekt i kontrollit të përbashkët. Sipërmarrjet e përbashkëta mund të marrin formën e aktiviteteve të kontrolluara së bashku, të aktiveve të kontrolluara së bashku, ose të njërive të kontrolluara së bashku.

Modeli i kostos

Shoqeria mat investimet e saj në njësitë ekonomike të kontrolluara bashkërisht me kosto pakësuar me ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi i njohur në përputhje me SKK 5 Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale.

Shoqeria njihë shpërndarjet e marra nga investimi si të ardhura, pa marrë parasysh nëse shpërndarjet janë nga fitimet e njërive ekonomike të kontrolluar bashkërisht të akumuluar para ose pas datës së blerjes.

Riorganizimi i grupit dhe transferimi i shoqerive të kontrolluara

Balfin sh.p.k si një shoqeri meme (holding) të një numri filialesh që i zotëron në mënyrë direkte ose indirekte, mund të ndermarre riorganizime të strukture zotëruese brenda kompanive të grupit. Keto ri-organizime kryehen për arsye të ndryshme si përmirësimi i koordinimit midis bizneseve, përmirësimi i strukture së mbikqyrjes së tyre, krijimi i shoqerive ligjore për të ushtruar një biznes specifik e të tjera.

Transferimet e pronësive brenda grupit kur kontrolli efektiv nuk ndryshon, mund të behen me pagese ose pa, në formën e kontributit apo shpërndarjes. Keto transferime dhe ristrukturime të formës ligjore të pronësive nuk kanë asnjë ndikim në strukturën e konsoliduar të grupit dhe nuk shkaktojnë të ardhura apo shpenzime. Për këto arsye, keto transferime kryehen me vlerën kontabel në pasqyrat individuale të kompanive duke qenë se thelbi ekonomik i transaksionit është riorganizimi i grupit dhe jo gjenerimi i fitimit.

3 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

3.3 Instrumentat Financiare (vazhdim)

Aktivi financiar nga investimet në bursë

Shoqëria njeh vlerën kontabel të mbartur të aktivitetit financiar dhe për çdo ndryshim në flukset monetare i njeh si fitimin ose humbjen nga ndryshimi nëpërmjet fitimit ose humbjes. Vlera bruto e mbartur e aktivitetit financiar rillogetaritet si vlera kontabel e mbartur plus flukset të mjeteve monetare të ndodhura deri në fund të vitit.

Mjete monetare dhe të tjerë ekuivalentë

Mjete monetare dhe të tjerë ekuivalentë përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së flukseve monetare, mjetet monetare dhe të tjerë ekuivalentë përfshijnë depozita pa afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se Shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitorit të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme dhe të tjera të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Huamarrje

Huamarrjet njihen fillimisht me kosto dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve.

Të tjerë

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Vlera e drejtë

Vlera e drejtë e përlllogaritur për mjetet monetare dhe të tjerë ekuivalentë, llogari të arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme, llogari të pagueshme dhe të tjera të pagueshme, huamarrjeve, përafron me vlerat e tyre kontabël.

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapital.

3.4 Aktivët Afatgjatë investimi

Aktive afatgjatë investimi, të cilat janë prona të mbajtura për të fituar të ardhura nga qerata dhe / ose për rivlerësimin e kapitalit (duke përfshirë prona në ndërtim për qëllime të tilla), maten fillimisht me kosto, duke përfshirë koston e transaksionit. Ato njihen fillimisht në pasqyrën e pozicionit financiar në momentin që rreziqet dhe përfitimet nga pronësia transferohen te shoqëria pavarësisht nga fakti nëse titulli është transferuar apo jo. Ato maten fillimisht me kosto. Pas momentit të njohjes, në vijim aktivët afatgjatë investimi maten me modelin e koston. Aktivët afatgjatë investimi, të cilat janë në proces ndërtimi të lidhura me projekte të reja me të cilat po merrët shoqëria, për ndërtimin e magazinave që do të jepen me qera ku përfshirja e shoqërisë në menaxhimin do të jetë minimale. Si e tillë, shoqëria po llogarit kostot direkte të ndodhura gjatë procesit të ndërtimit dhe sjelljes së aktivitetit në kushtet për tu dhënë me qera.

3 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**3.5 Aktivet Afatgjata Materiale***Njohja dhe matja*

Te gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostot përfshijnë shpenzimet që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejte me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të ndërtuara nga vetë shoqëria përfshin koston e materialeve dhe punës direkte dhe kosto të tjera që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë për sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin që i është caktuar, kostot e çmontimit dhe lëvizjes së aktiveve dhe kthimin e vendodhjes së tyre në gjendjen e mëparshme, si dhe kostot e kapitalizuara të huave. Kostot gjithashtu mund të përfshijnë zëra të transferuar nga të ardhurat të tjera përmbledhëse për fitime apo humbje të kualifikimit të flukseve të parasë të mbuluara nga blerjet në monëdhë të huaj të aktiveve afatgjata materiale. Blerja e programeve kompjuterike të cilat janë pjesë përbërëse e funksionimit të paisjeve përkatëse kapitalizohet si pjesë e asaj paisjeje. Në momentin që një nga aktivet afatgjata materiale përbëhet nga pjesë me jetëgjatësi të dobishme të ndryshme, ato regjistrohen si pjesë të ndara nga njëra tjetra. Fitimet ose humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale percaktohen duke krahasuar arkëtimet nga shitja me vlerën kontabël neto të aktivitetit afatgjatë material dhe njihen neto në të ardhura ose humbje të tjera.

Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që Shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur, për të gjitha aktivet, mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Përmirësimet e aktiveve të marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit. Toka nuk amortizohet.

Jetëgjatësia e vlerësuar për periudhën aktuale dhe metodat respektive të amortizimit janë si më poshtë:

a) Makineri e Pajisje	20%
b) Mjete transporti	20%
c) Pajisje informatike	25%
d) Instalime	20%
e) Te tjera	20%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

3.6 Aktive afatgjata jomateriale*Njohja dhe matja*

Aktivitet jomateriale të blera nga shoqëria maten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe rënie në vlerë të akumuluar.

Kostot në vijim

Kostot në vijim kapitalizohen vetëm kur ato rrisin përfitimet e ardhshme ekonomike nga aktivi specifik me të cilat lidhen. Të gjitha shpenzimet e tjera, duke përfshirë shpenzimet e gjenerimit të emrit të mirë dhe markës, njihen në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse (në humbje ose fitime) në momentin e ndodhjes.

3 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

3.6 Aktive afatgjata jomateriale (vazhdim)

Amortizimi

Amortizimi llogaritet mbi koston e aktiveve, ose cdo vlerë tjetër të konsideruar si kosto, minus vlerën e mbetur. Amortizimi njihet në të ardhura ose shpenzime duke përdorur metodën e vlerës së mbetur.

Zhvlerësimi

Aktivët financiarë

Një aktiv financiar që nuk mbahet me vlerën e drejtë, vlerësohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna objektive që ka pësuar rënie në vlerë. Një aktiv financiar bie në vlerë nëse ka të dhëna objektive të një ngjarje që ka çuar në rënien e vlerës së tij pas momentit fillestar të njohjes së aktivitetit, dhe kjo ngjarje ka efekt negativ në vlerësimin e flukseve të ardhshme nga aktivi të cilat mund të maten me besueshmëri.

Humbja nga rënia në vlerë e aktivitetit të vlerësuar me koston e amortizuar llogaritet si diferencë midis vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme që priten të gjenerohen nga ky aktiv financiar të aktualizuara me normën fillestare efektive të interesit. Humbjet njihen në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse (në humbje ose fitim) në një llogari zbritje kundër të arkëtueshmet. Interesi nga aktiviteti e zhvlerësuar në këtë mënyrë vazhdon të njihet nëpërmjet amortizimit të skontos. Kur një ngjarje pasuese shkakton zvogëlimin e rënies në vlerë, shuma përkatëse rimerret nëpërmjet pasqyrës përmbledhëse të të ardhurave, fitimit ose humbjeve.

Aktivët jo financiarë

Vlera kontabël e aktiveve jo financiare të shoqërisë rishikohet në datën e raportimit për të përcaktuar nëse ka ndonjë të dhënë për rënie në vlerë. Nëse ekziston ndonjë evidence e tillë atëherë matet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Vlera e rikuperueshme është vlera më e madhe midis vlerës së drejtë minus koston e shitjes dhe vlerës në përdorim. Gjatë vlerësimit të vlerës në përdorim, flukset e ardhshme të vlerësuar skontohen në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para tatimit, e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe risqeve specifike të aktiveve që nuk janë marrë parasysh në vlerësimin e flukseve të ardhshme. Humbje nga rënia e vlerës njihet nëse vlera kontabël e aktivitetit ose e njësisë së tij të gjenerimit të parasë tejkalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

3.7 Provigjonet

Provigjoni njihet kur, si pasojë e ngjarjeve të kaluara, shoqëria ka detyrime aktuale ligjore apo konstruktive të cilat mund të vlerësohen me vërtetësi, dhe ka mundësi që të ketë nxjerrje të flukseve të ardhshme të parasë për të shlyer këtë detyrim. Provigjonet përcaktohen nga aktualizimi i flukseve të pritshme me një normë para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut të parasë dhe rrezikut specifik të detyrimeve.

3.8 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat janë flukset bruto të përfitimeve ekonomike gjatë periudhës të cilat gjenerohen përgjatë ecurisë normale të aktivitetit të biznesit.

Të ardhurat janë hyrje bruto të përfitimeve ekonomike gjatë periudhës, të cilat vijnë nga veprimtaria e zakonshme e një njësie ekonomike kur këto hyrje sjellin rritje në kapitalin neto, përveç rritjeve që lidhen me kontributet nga pjesëmarrësit në kapital. Të ardhurat përfshijnë vetëm vlerën e drejtë të përfitimeve ekonomike të marra dhe ato që janë për t'u marrë nga shitja e mallrave dhe shërbimeve gjatë aktivitetit të zakonshëm të kompanisë.

3 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

3.8 Njohja e të ardhurave (vazhdim)

Te ardhurat përfshijnë shumat neto pa përfshire shumat e mbledhura për llogari të palëve të treta si taksat e shitjes, taksat e mallrave, produkteve dhe shërbimeve, si dhe tatimi i vlerës së shtuar, të cilat nuk janë përfitime ekonomike që hyjnë në njësinë ekonomike dhe nuk sjellin rritje të kapitalit neto. Në lidhje me shitjen e mallrave, te ardhurat janë njohur kur ndryshimi i pronësise së bashku me riskun që vjen nga ky ndryshim, janë transferuar tek blerësi.

3.9 Të ardhurat nga qeratë

Të ardhurat nga qeraja janë të ardhura të përfituara nga kontratat e qerasë, përveç të ardhurave të kushtëzuara të qerasë të cilat njihen kur përfitohen. Kostot fillestare direkte që ndodhin gjatë negociimit të një kontrate qeraje njihen si shpenzime në termat e qerasë me të njëjtat baza sit ë ardhurat nga qeraja.

Përpyekjet për të nënshkruar një kontratë qeraje janë shpërndarë në mënyrë të barabartë përgjatë aftatit të kontratës së qerasë edhe nëse këto pagesa nuk bëhen në këto baza. Afati i qerasë është një periudhë e pa anulueshme qeraje së bashku me afate të tjera të mëtejshme për të cilat qeramarrësi ka opsionin për të vazhduar qeranë, kur, në fillim të qerasë drejtimi ka një siguri të arsyeshme që qeramarrësi do ta ushtrojë këtë opsion.

Shumat e marra nga qeramarrësi për përfundimin e qerasë ose kompesimin e përfundimit të saj njihen në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse kur lind e drejta për ti marrë ato.

3.10 Pagesat për qeranë financiare

Qeratë klasifikohen si qera financiare kur kushtet e qerasë transferojnë në mënyrë domethënëse të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë tek qeramarrësi. Të gjitha qeratë e tjera klasifikohen si qera operative. Pagesat e bëra për qeranë operative janë paraqitur në pasqyrën e të ardhurave në bazë lineare përgjatë kohëzgjatjes së kontratës

Depozitimet e qeramarrësit

Detyrimet e depozitimeve të qeramarrësit fillimisht njihen me vlerë të drejtë dhe maten më kosto të amortizueshme kur është materiale. Diferencat ndërmjet vlerës fillestare të drejtë dhe shumës nominale përfshihet si një komponent i të ardhurave nga kontrata e qerasë dhe njihen në bazë lineare përgjatë kohëzgjatjes së kontratës.

3.11 Te ardhurat financiare dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përbëhen nga të ardhurat nga interesi për fondet e investuara në depozita bankare dhe nga të ardhurat nga kursi i këmbimi.

Kostot financiare përbëhen nga shpenzimet e interesit të huave, shpenzime nga kurset e këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare në fitim dhe humbje nga rënia në vlerë e aktiveve financiare.

Humbjet apo fitimet nga kursi i këmbimit janë paraqitur në vlerë neto.

3.12 Kostot e huamarrjes

Kostot e huave të lidhura direkt me blerjen, ndërtimin ose prodhimin e aktiveve, të cilat duan një kohë të gjatë për t'u sjellë në formë përfundimtare, në mënyrë që të përdoren apo shiten, i shtohen koston së këtyre aktiveve, deri në momentin kur këto aktive janë gati për qëllimin e tyre për përdorim ose për shitje.

Të ardhurat nga investimet e përkohshme, për sa i përket disa huave të veçanta, të cilave ende nuk ju është paguar interesi, kjo shumë ju zbritet kostove të huamarrjes dhe nuk i kapitalizohet koston së aktivit.

Të gjitha kostot e tjera njihen si të ardhura ose shpenzime në periudhën kur ato kanë ndodhur.

3 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

3.12 Taksat

Bazuar në SKK 11 "Tatimi mbi fitimin", për vitin 2015 ky standard behet i detyrueshem dhe do te zbatohet ne prespektive. Shoqëria nuk ka aktive apo detyrime tatimore te shtyra në pasqyrat financiare për periudhën që mbyllet më 31 dhjetor 2016.

Tatimi mbi fitimin nënkupton tatimin e periudhës dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në të ardhura ose shpenzime përveç rasteve kur lidhen me zera të njohur direkt në kapital, në të cilat regjistrohen direkt në kapital.

Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm, i pagueshëm mbi fitimin e tatueshem për vitin, duke përdorur normat e tatimeve në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo sistemim mbi tatimin e pagueshëm të lidhur me vitet e mëparshme.

BALFIN SH.P.K**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017***(Gjithë vlerat janë shprehur në mijë Lek)***4 MJETE MONETARE DHE TE TJERE EKVIVALENTE**

Mjetet monetare dhe të tjerë ekuivalentë më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Mjete Monetare		
I. Para në dore	247	22
Ne monedhe vendase	168	3
Ne monedhe të huaj	79	19
II. Llogari në banke	1,827,939	2,424,071
Ne monedhe vendase	54,551	78,952
Ne monedhe të huaj	1,773,387	2,345,118
III. Depozite afatshkurter	537,950	676,650
Total mjete monetare (I+II+III)	2,366,136	3,100,743

5 KERKESA TE ARKETUESHME

Ne kete ze jane perfshire "Kerkesa te arketueshme" nga klientet dhe shoqeri te Grupit.

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Kërkesa të arkëtueshme nga kompanite e grupit	117,132	56,765
Kërkesa të arkëtueshme nga te tretet	6,902	11,772
Total	124,034	68,538

6 HUADHENIE AFATSHKURTER BRENDA GRUPIT

Ne kete ze jane perfshire huadheniet brenda kompanive te grupit.

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Huadhënie brenda grupit	1,147,239	667,097
Totali	1,147,239	667,097

7 INVESTIME TE TJERA

Investime te tjera kane te bejne me investime qe kompania perfiton ne tregjet e kapitalit ne Shtete e Bashkuara te Amerikes. Nenshkrimet dhe shitjet e kuotave në bursën publike te SHBA kryhen nga Shoqeria nepermjet nje kompanie komisionere.

8 KERKESA TE TJERA TE ARKETUESHME

Kerkesa te tjera te arketueshme me 31 dhjetor 2017 dhe 2016 perbehen si me poshte:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Kërkesa të tjera nga kompani të kontrolluara	-	227,221
Hua ndaj palëve të Treta	170,969	48,875
Huadhënie brenda grupit	26,328	26,710
Kërkesa të tjera nga kompani jo të kontrolluara	-	11,845
Parapagime të dhëna	8,011	5,000
Tatim Fitim i Parapaguar	3,080	3,080
Klientë për fatura të pambërritura	3,766	1,814
Paradhënie Punonjësve	3,095	571
Totali	215,249	325,118

BALFIN SH.P.K**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017***(Gjithë vlerat janë shprehur në mijë Lek)***9 SHPENZIME DHE TE ARDHURA TE SHTYRA**

Shpenzime të shtyra më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 përbehen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Shpenzime të periudhave të ardhshme	2,663	946
Te ardhura të llogaritura	10,407	1,895
Totali	13,070	2,841

Ne këtu janë përfshirë shpenzime të cilat i takojnë me shumë se një periudhë ushtrimore, dhe amortizohen në një vit kalendarik të tilla si: sigurime vjetore për automjetet e shoqërisë, abonime, e të tjera, dhe këto shpenzime nuk i përjashtojnë të gjitha vitet 2017 por dhe vitin pasardhës, dhe si të tilla janë klasifikuar si shpenzime të shtyra për tu amortizuar në vitin 2018.

Te ardhurat e llogaritura janë te ardhurat nga interesat të cilat nuk janë maturuar akoma.

BALFIN SH.P.K**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017***(Gjithë vlerat janë shprehur në mijë Lek)***10 AKSIONE DHE PJESEMARRJE TE TJERA NE NJESITE E KONTROLLUARA**

Ky ze përfshin investimet e shoqërisë në blerjen e aksioneve të paleve të lidhura. Në tabelën e mëposhtme jepet pjesëmarrja në vlerë dhe përqindje deri më 31 dhjetor 2017.

	31 dhjetor 2017	%	31 dhjetor 2016	%
Tirana Logistic Park	1,713,117	100%	1,476,168	64.41%
QTU	1,110,523	100%	-	-
Green Coast	875,417	100%	434,735	100%
Mane TCI	689,750	100%	689,750	100%
Spar	600,503	100%	600,503	100%
Alb Chrome Holding	266,700	100%	100	100%
BFI Invest	173,779	100%	67,355	100%
ALCRED	114,723	100%	114,723	100%
AES	101,303	100%	101,303	100%
Neptun	90,000	90%	90,000	90%
MZF	86,600	100%	86,600	100%
Balfin BV	52,621	100%	-	-
Acr Srl	5,144	100%	5,144	100%
Neptun Ks	4,190	60%	4,199	60%
TH&B	3,119	67%	-	-
ACREM	100	100%	100	100%
Electroservice	90	90%	90	90%
Kid Zone KS	77	55%	77	55%
Kid Zone doo	63	90%	63	90%
BFI Trade	1	100%	-	-
Kid Zone	0.09	90%	0.09	90%
SACCTA	-	-	910	100%
Neptun Maqedoni	-	-	19,452	60%
Agrocon	-	-	203,310	100%
Total	5,887,819		3,894,581	

11 AKSIONE DHE INVESTIME TE TJERA NE PJESEMARRJE

Në këtë ze përfshihen investimet në shoqëritë e pakontrolluara (aksione dhe pjesëmarrje të tjera në njësi të pa kontrolluara) deri më 31 dhjetor 2017 situata e detajuar paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	%	31 dhjetor 2016	%
Balfin Finance B.V	17,184	50%	135,760	50%
FINAL	55,250	48.43%	55,250	40.43%
Milsped	28,040	50%	28,040	50%
Stella Mare	13,694	50%	13,694	50%
TBU	429	30%	429	30%
Macrem	174	25%	174	25%
Balfin BV	-	-	1,369	50%
Te tjera	19,730		36,750	
Total	134,502		271,466	

BALFIN SH.P.K**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017***(Gjithë vlerat janë shprehur në mijë Lek)***12 LLOGARI/KERKESA TE ARKETUESHME AFATGJATA**

Llogarite e Arketueshme Afatgjata janë kryesisht nga kompani të cilat janë në zotërim nga Balfin sh.p.k. Llogari/Kërkesa të Arkëtueshme Afatgjata përbëhet si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Nga shoqëri të kontrolluara	645,983	788,734
Nga shoqëri me pjesëmarrje të përbashkëta	-	481
Te tjera	227,776	30,010
Total	873,758	819,226

13 TITUJ TE HUADHENIES

Tituj të huadhenies përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Tituj të huadhenies afatgjate brenda grupit	-	421,453
Tituj të tjere të huadhenies	147,544	559,146
Total	147,544	980,598

Tituj të tjere të huadhenies është huadhenia në favor të të tjerëve në referim të kontratave ndërmjet paleve.

BALFIN SH.P.K**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017***(Gjithë vlerat janë shprehur në mijë Lek)***14 AKTIVE AFATGJATA MATERIALE DHE JO-MATERIALE**

Aktivet afatgjata materiale dhe jomateria me me 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 perbehet si me poshte:

Aktive Afatgjata Materiale	Software	Instalime Teknike dhe Pajisje	Mjete Transporti	Pajisje zyre dhe informatike	Mobilieri e Pajisje	Total
Kosto historike:						
Gjendja ne 31 dhjetor 2015	1,160	7,181	8,498	34,382	14,169	65,390
Shtesa	-	-	10,074	3,296	711	14,081
Pakësime	-	-	(5,532)	-	-	(5,532)
Gjendja ne 31 dhjetor 2016	1,160	7,181	13,040	37,678	14,880	73,939
Shtesa	-	1,402	7,486	17,533	693	27,115
Pakësime	-	-	-	-	-	-
Gjendja ne 31 dhjetor 2017	1,160	8,584	20,527	55,211	15,573	101,054
Amortizimi i akumuluar:						
Gjendja ne 31 dhjetor 2015	(290)	(1,022)	(5,299)	(20,492)	(11,566)	(38,668)
Pakësime	-	-	2,948	-	-	2,948
Shpenzimi i vitit	(145)	(1,214)	(1,728)	(3,532)	(805)	(7,424)
Gjendja në 31 dhjetor 2016	(435)	(2,236)	(4,079)	(24,024)	(12,371)	(43,144)
Shpenzimi i vitit	(145)	(1,033)	(2,973)	(4,979)	(739)	(9,869)
Gjendja në 31 dhjetor 2017	(580)	(3,268)	(7,052)	(29,002)	(13,111)	(53,013)
Vlera e mbetur me:						
31 dhjetor 2016	725	4,946	8,962	13,654	2,508	30,795
31 dhjetor 2017	580	5,315	13,475	26,209	2,462	48,041

Drejtimi mendon se përgjithësisht për këtë vit ushtrimor kontabël, nuk ka shenja të rënies në vlerë të AAM-ve dhe nuk ka llogaritur zhvlerësime. Nuk ka aktive te vendosura si kolateral.

BALFIN SH.P.K**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017***(Gjithë vlerat janë shprehur në mijë Lek)***15 HUAMARRJET AFATSHKURTRA**

Huamarrjet afatshkurtra perbehen nga pjesa afatshkurter e huamarrjes ne sistemin bankar te nivelit te dyte dhe detyrime te tjera afatshkurtra qe pritet te mbyllen brenda vitit 2017.

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Hua afatshkurter ne sistemin bankar	27,779	48,437
Hua nga shoqeri te kontrolluara	25,925	-
Te tjera	19,600	36,750
Detyrime nen Lizing Financiare	1,182	1,602
Letra me Vlere	-	140,000
Total	74,486	226,789

16 DETYRIME AFATSHKURTRA

Detyrime afatshkurtra perfaqeson detyrimet tregetare te kompanise per furnitoret e saj.

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Të pagueshme ndaj furnitorëve	33,136	52,393
Total	33,136	52,393

17 DETYRIME AFATSHKURTRA PER PUNONJESIT DHE TATIMET

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Sigurime Shoqerore dhe te ngjashme	3,108	1,645
Shteti – Tatim mbi paga	2,085	1,477
Tatim ne Burim	2,125	1,261
TVSH	275	855
Paga te pagueshme	1,041	822
Total	8,634	6,059

18 HUAMARRJE DHE DETYRIME AFATGJATA

Ne kete llogari jane paraqitur detyrimet e shoqerise per financimet e marra nga ortaku i tij i vetem si edhe nga shoqerite e grupit, per investimet e kryera. Kontributi i kryer nga ortaku do te konsiderohet te kaloje ne rritjen e kapitalit te shoqerise ne nje moment te mevonshem. Persa i perket kontributeve te marra nga shoqerite e tjera te grupit keto fonde te ti kthehen ne vitet ne vijim. Gjithashtu ketu persfshihet dhe pjesa afatgjate e detyrimeve afatgjate per huate nga sistemi bankar.

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Kontribut nga ortaku	256,599	426,533
Huamarrje nga shoqeri te kontrolluara	1,105,234	637,547
Hua dhe detyrime te tjera	1,000,331	1,659,546
Hua Afatgjate nga sistemi bankar	-	28,255
Total	2,362,164	2,751,881

19 SHITJET NETO

Ne kete rubrike jane paraqitur te ardhurat nga aktiviteti i shoqerise qe eshte sherbimi i konsulences. Ky sherbim perfshin konsulence financiare, juridike, teknologjise se informacionit dhe menaxheriale. Te ardhura nga kontrata te tjera qeraje, shitje e AQT dhe te ardhura te tjera nga njohja e te ardhurave nga shit-blerje e kuotave, te ardhurat nga instrumentat financiare etj.

Shitjet neto	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Sherbim konsulence	207,648	155,096
Te ardhura te tjera sipas kontratave	25,923	103,467
Total	233,571	258,563
Të ardhura të tjera		
Te ardhura nga qerate	252	537
Te ardhura nga shitja e AQT	47	2,345
Te ardhura te tjera operative	31,918	-
Total	32,216	2,882
Total	265,787	261,445

20 TE ARDHURA TE TJERA NGA VEPRIMTARITE E SHFRYTEZIMIT

Ne kete ze jane perfshire te ardhurat nga dividendet. Gjate vitit 2017 shoqeria ka njohur si te ardhura nga dividenti i shperndare nga shoqerite e kontrolluara.

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Te ardhura nga Dividentet nga shoqeri te kontrolluara	1,483,021	1,513,078
Te ardhura nga Dividentet nga shoqeri jo te kontrolluara	168,682	1,728,045
Total	1,651,704	3,241,124

21 SHPENZIME NGA VEPRIMTARITË E SHFRYTËZIMIT

Shpenzimet jane njohur mbi bazen e te drejtave te konstatuara. Shpenzimet e tjera te veprimtarise, te klasifikuara sipas natyres, jane paraqitur ne vijim:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Zhvlerësim i investimeve kapitale	88,890	378,944
Zhvlerësim i llogarive të arkëtueshme	30,151	-
Shpenzime të tjera për shërbime	26,847	28,406
Transferime, udhëtime dieta	25,724	5,293
Qera	22,918	20,506
Të tjera për personelin	17,623	3,051
Shpenzime të tjera	8,435	10,938
Shpenzime ligjore	7,536	8,395
Shpenzime postare dhe telekomunikacion	7,090	4,848
Shpenzime marketing	3,753	3,182
Për karburant	2,686	2,989
Ambjente te perbashketa	2,602	2,287
Shpenzime për pritje dhurata, sponsorizime	5,681	1,790
Blerje energji/ujë/avull	2,827	2,254
Shpenzime të tjera për zyrë	1,652	1,647
Shpenzime për shërbime bankare	1,210	791
Shpenzime te tjera per kancelari	1,046	580
Për riparim makinash	468	99
Mirembajtje dhe riparime	371	-
Per sigurim dhe taksa	306	374
Taksa dhe tarifa vendore	134	128
Penalite dhe Gjoha	11	-
AQT të shitura	-	2,584
Shpenzime për trajnim personeli	-	10,354
Total	257,963	489,440

BALFIN SH.P.K**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017***(Gjithë vlerat janë shprehur në mijë Lek)***22 SHPENZIME TE PERSONELIT**

Shpenzimet per personelin perfaqesonje shpenzimet per paga shperblime dhe per shpenzimet shoqerore shendetesore te shoqerise.

Shpenzime per Personelin	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Paga dhe shpërblime	139,595	96,880
Shpenzime të sigurimeve shoqërore	13,002	9,456
Total	152,597	106,336

23 TE ARDHURA DHE SHPENZIME NGA INTERESI

Ne kete ze perfshihen te ardhura/shpenzime nga financimet e marra dhe te dhena, si dhe fitim/humbjet nga kembimet valutore.

Të ardhurat dhe shpenzimet financiare	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Te ardhura nga interesat	59,330	10,642
Shpenzime per interesa	(3,677)	(13,346)
Total	55,653	(2,704)

24 HUMBJE NGA KURSI I KEMBIMIT

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Fitimi nga kembimet valutore	55,167	15,080
Humbje nga kembimet dhe perkthimet	(110,870)	(73,687)
Total	(55,703)	(58,608)

25 SHPENZIMET E TATIM FITIMIT

Shpenzimi i tatim fitimit i llogaritur për vitin ushtrimor 2017 bazohet në detyrimin për tatim fitimin sipas Legjislacionin Fiskal në Shqipëri. Norma aktuale e tatimit mbi fitimin për vitin 2017 eshte 15%. Niveli taksimit per fitimin zbatuar në vitin paraardhës 2016 ka qënë 15%. Për vitin ushtrimor shoqëria rezulton me një fitim neto të realizuar në vlerën 1,497,006 mijëra Leke.

Më poshtë jepet detajimi i llogaritjes së tatim fitimit:

Rezultati tatimor	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Fitimi para tatimit	1,497,006	2,838,067
Te ardhura te perjashtuara (nga dividendet)	(1,651,704)	(3,241,124)
Te ardhura te pa tatueshme	(1,104)	(374)
Shpenzime te pazbritshme	122,814	399,322
Fitimi / (humbje) i tatueshem i ushtrimit	(32,998)	(4,108)
Tatim fitimi	-	-

Sipas legjislacionit shqiptar humbjet tatimore mund te mbarten deri ne 3 vjet.

26 ANGAZHIMET DHE DETYRIMET E KUSHTEZUARA

Me 31 dhjetor 2017, shoqëria ka angazhime me disa banka të nivelit të dytë në Shqipëri duke qenë se është bashkë huamarrese ose garantore për disa prej kompanive të kontrolluara prej saj dhe kompanive të pa kontrolluara në vlerat si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Garanci për shoqëritë e kontrolluara	1,681,625	2,820,461
Garanci për shoqëritë e me pjesëmarrje të përbashkët	1,992,985	59,118
Total	<u>3,674,610</u>	<u>2,879,579</u>

27 NGJARJE PAS DATES SE BILANCIT

Nuk ka asnjë ngjarje të mëposhme pas datës së raportimit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.